

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E HËNË 11 PRILL 2022

E nderuar zonja Zëvendëskryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Megjithëse 4 minuta janë të pamjaftueshme për të treguar ndodhitë e këtyre 6 javëve që kemi kaluar, unë do të ndalem disa sekonda që, si dëshmitar i një agresioni verbal ndaj jush dhe ndaj këtij Kuvendi, t'ju kërkoj falje dhe t'u bëj thirrje të gjithë kolegëve, sidomos kolegëve burra, që të japim shembullin tonë, duke respektuar ato rregulla që i kemi miratuar së bashku. Për të kaluar nga agresioni verbal, në atë agresionin e vërtetë të luftës, nuk ka shqiptar që nuk e di që më 24 shkurt, kur Presidenti Putin vendosi të kalojë tanket në hambarin europian, oferta e drithit mori një goditje, që nuk e kishte marrë që nga Lufta e Parë Botërore, ndaj sot çmimi i drithit është 40% më i lartë.

Në të njëjtën ditë, kur Presidenti Putin vendosi të kyçë magazinën më të madhe të lëndëve të para, çmimi i karburantit u ngrit në atë pikë që nuk ishte ngritur që nga koha kur Saddam Hyseini kaloi kufirin kuvajtian. Nuk ka shqiptar që nuk e di se tubat e gazit dhe të naftës janë tërësisht nën presionin e agresionit në Lindje, ndaj edhe çmimet e energjisë janë ato që ne shohim përditë. Ndaj barbaria e çmimeve që ka ardhur në derën e gjithsecilit nga ne, ka një burim: luftën, agresionin e padrejtë që po ndodh sot në Ukrainë. Nuk ka shqiptar që nuk e di këtë. Jam i sigurt që këtë e keni dëgjuar në çdo shtëpi që keni shkuar gjatë javës së kaluar. Le ta dinë shumë mirë të gjithë kolegët që, sado të përpiqemi, me spekulime të caktuara, ne nuk mund ta mbysim dot të vërtetën, sepse, mirë gjithë kjo barbari çmimesh, që ne po përjetojmë, por nuk na lë rehat as zallahia e spekulimeve. Spekulatorëve të çmimeve ua gjetëm dermanin, sepse janë një sërë bordesh, që merren përditë dhe në mënyrë transparente u tregojnë qytetarëve si rezulton çmimi i lëndëve të importit.

Problemi më i vështirë është i spekulatorëve të gjysmë të vërtetave, të cilët sot përsëri zunë një pjesë të kohës suaj. Për ata shqiptarë, të cilët nuk janë të vëmendshëm për të parë si krijohet çmimi, mund të zënë pak vend dhe ky është problemi. Shumë shkurt në atë 1 minutë e 10 sekonda që ka ngelur, dua të them që në 6 javë ne u përpoqëm të dëgjonim mirë, të dëgjonim mirë pensionistët; të dëgjonim mirë udhëtarët; të dëgjonim mirë fermerët; të dëgjonim mirë çdo familje shqiptare, ndaj, si shumicë parlamentare, brenda 6 javësh vendosëm të sillnim një paketë rezistence. Ne nuk e dimë se kur mbaron lufta, se nuk është një luftë që e kemi nisur ne, por ajo çka ne dimë mirë është që, kur shqiptarët janë në ditë të vështira dhe bëhen bashkë, mund t'ia dalin.

Prandaj ne sot mund të flasim dhe e kuptoj shqetësimin, madje edhe një lloj paniku, se kur vendosin socialistët të dëgjojnë, kundërshtarët tanë i zë paniku, sepse përmes dëgjimit ne mund të sjellim ato çështje që kanë rëndësi për shqiptarët dhe nuk do të na dëgjoni ndonjëherë të flasim: "Cilën bravë të

ndërrojmë, cilin kyç të fusim”. Çështjet që do të dëgjoni nga kjo shumicë parlamentare, janë çështje që lidhen drejtpërdrejt me tryezat tuaja dhe me sigurinë në familjet tuaja. Faleminderit!